



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 458/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur lidhur me apelin e Fidan Klinaku, kandidat për deputet nga koalicioni Nisma-Akr-PD, Komuna Vushtrri, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në VV e Komunës së Vushtrisë, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet** e pabazuar apeli Anr.458/2019 e datës 08.11.2019, e paraqitur nga Fidan Klinaku, kandidat për deputet nga koalicioni Nisma-Akr-Pd, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të datës 07.11.2019, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në VV e Komunës së Vushtrisë.

### A r s y e t i m

Me datë 08.11.2019, kandidati për deputet nga radhët e koalicionit Nisma-Akr-PD, Fidan Klinaku nga Komuna e Vushtrisë, ka paraqitur në PZAP, apelin Anr.458/2019, me të cilën pretendon se në listën garuese të koalicionit Nisma-Akr-PD nr.122 me numrin kandidues 80, pas verifikimit të FRK-ve për vendvotimet e Komunës së Vushtrisë të publikuara në faqen e KQZ-së, si kandidat ka marrë 313 vota, ndërsa në shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve nga KQZ-ja, sipas vendimit 1659-2019 del se në vendvotimet e kësaj komune ka marrë 250 vota. Sipas paraqitësit të apelit është bërë lëshime në bartjen e rezultateve.

Parashtrësia e ankesës ka kërkuar nga PZAP-i që nëpërmjet KQZ-së, të rinumërojë kutit e votimit në VV e Komunës së Vushtrisë, siç janë:

2701B/01R/02R/03R/04R/06R/07R/08R/10R/11R/12R/13D,2702B/01R/02R/04R/05D,2702X/01R/05D,2703B/01R/02D,2704B/02R/03R/04R/05R/06R/07R/08R/09R/10R/11R/12R/13R/14D,2705D/01D,2706D/01R/02D, 2707B/01R/02R/03D,2708B/01R/02D,2709B/01R/03D,2710B/02R/03D,2711B/01R,2712B/01R/02R,27013B/01R/02R/03R/04R/05D,2714B/02R/04D,2715B/01D,2716B/01R/02R/03D,2717B/01R/02R/03R,2718B/01D,2720B/01R/02D,2721B/01R/02D,2722B/01R/02D,2724B/01D,2725B/01D,2726B/01D,2727B/02D,2728B/01D,2729B/02R/03D, 2731B/01R/02D.

Në përgjigjen në apel të pranuar nga KQZ-ja theksohet se në bazë të Rregullës Zgjedhore 06/2013, procedura e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve nuk lejon asnjë Formular të Rezultateve të kalojë (të procedohet si i rregullt) nëse nuk përputhen votat e subjekteve me votat e Kandidatëve, që do të thotë se nëse subjekti nuk ka vota dhe kandidatët kanë vota, atëherë Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim ose subjekti ka vota dhe kandidatët nuk kanë vota, Formulari nuk procedohet i rregullt dhe shkon në Auditim. Auditimi kontrollon të gjitha këto raste dhe në bazë të të gjeturave përgatit raportin dhe QNR-ja në bazë të raportit të Auditimit, rekomandon KQZ-në, që vendvotimet që kanë

probleme të kësaj natyre të Rinumërohen. Në vazhdim të përgjigjes theksohet se pala ankuese nuk ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka prezentuar mjaftueshëm prova për rastin konkret.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pabazuar**

Paneli, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase paraqitësi i apelit me apelin e tij e kërkon që të rinumërohen të gjitha kutitë e votimit në Komunën e Vushtrris, sepse nga rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ i njëjti posedon 250 vota, ndërsa sipas paraqitësit të apelit në këto vendvotime ka marrë 313 vota.

Mirëpo nga pretendimet ankimore me asnjë provë bindëse nuk është dëshmuar se në cilin VV është bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje paneli apelin e paraqitësit e konsideron si të përgjithshme dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, paneli, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase paraqitësi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për ti vërtetuar pretendimet ankimore edhe pse barra e te provuarit bie mbi paraqitësin e apelit, po ashtu nuk ka specifikuar se në cilat VV i mungojnë votat konkretisht, por në apelin e tij i ka përkrahur të gjitha VV e Komunës së Vushtrrisë, por nuk ka bashkangjitur asnjë provë shkresore që do ta argumentonin pretendimin e tij.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë apelin e apelusit e refuzon.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.458/2019 më datën 09.11.2019



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.